

Cikli I programeve: “PERMES BIBLES”

Emisioni nr 550 Ester 9

Perëndia ka një rrugë për të shpëtuar mëkatarët. Ju nuk jeni aq të mirë sa të shkoni në qiell dhe ju nuk keni për t’u bërë kurrë më të mirë. Perëndia duhet të punojë me ju. Unë dhe ti duhet të shkojmë tek Ai dhe të pranojmë shpëtimin që ai siguron për ne, një rrobë drejtësie që është e përsosur. Krishti na jep drejtësinë e Tij. Ti nuk mund ta përmirësosh dot atë që ka bërë ai.

Perëndia nuk mund të na marrë në qiell kështu si jemi. Ne duhet të lindemi sërish. Këtë i tha Zoti Jezus, Nikodemit, një drejtuesi jude: “... ti duhet të lindësh sërish.” (Gjon. 3:7). Tek 1 Pjetri 1:23, Zoti thotë: “sepse jeni ringjizur jo nga një farë që prishet, por që nuk prishet, me anë të fjalës së Perëndisë së gjallë dhe që mbetet përjetë.” Vetëm për shkak se njerëzit dëgjojnë dhe besojnë Fjalën e Perëndisë ata linden sërish dhe jetët e tyre fillojnë të ndryshohen.

Unë nuk u flas njerëzve për “përkushtimin e jetëve të tyre tek Zoti” sikur ata të kishin dicka për të përkushtuar. A mendoni se Ai e do jetën tuaj të vjetër? Miqtë e mi, Ai dëshiron t’ju japë një jetë të re. Ai dëshiron t’ju rigjenerojë. Ai dëshiron t’ju shpëtojë. Judenjve në kohën e Esterit u duhej të pranonin se ishte hartuar një dekret për t’i shfarosur. Atyre u duhej të besonin se mbreti ishte në anën e tyre dhe kishte siguruar një dekret tjetër për t’i shpëtuar. Ne, gjithashtu duhet të besojmë se Mbreti i mbretërve është në anën tonë. Unë jam një ambasador i Krishtit dhe për hir të Zotit duhet t’ju them: “... pajtohuni me Perëndinë.” (2 Kor. 5:20). Ai është pajtuar me ju.

Kështu u shpërnda ligji i dytë nga mbreti.

“Një kopje e dekretit, i shpallur si ligj në çdo krahinë, duhet të nxirrej për të gjithë popujt, me qëllim që Judejtë të ishin gati për atë ditë të hakmerreshin kundër armiqve të tyre. Kështu korrierët të hipur mbi kuaj të shpejtë u nisën të nxitur dhe të shtypur nga urdhri i mbretit; dhe dekreti u nxuar në qytetin e Suzës.” [Est. 8:13-14].

Ata duhet të nxitonin. Edhe ne duhet të nxitojmë sot. Nuk po përpiqem t'ju frikësoj, por kjo mund të jetë hera e fundit që keni mundësinë për të pranuar Krishtin si Shpëtimtarin tuaj. Tani është koha për t'i besuar Krishtit. E vetmja gjë për të cilën Zoti do që të nxitoheni miqtë e mi është që të pranoni Birin e Tij.

“Mardoheu doli nga prania e mbretit me një rrobe mbretërore të purpurt dhe prej liri të bardhë, me një kurorë të madhe prej ari dhe një mantel prej pëlhure liri në ngjyrë të kuqe flakë; në qytetin e Suzës dëgjoheshin britma gëzimi dhe ai ishte në festë.” [Est. 8:15].

Rroba mbretërore që ka veshur Mardoheu tani është ndryshe nga thesi me hi që kishte veshur para disa kohësh. Shfaqja e tij në qytet përforcoi gëzimin që ishte siguruar nga dekreti i mbretit. Vini re kontrastin midis dy dekreteve. Dekreti i Hamanit solli dhimbje, ndërsa dekreti i mbretit solli gëzim. Shpëtimi mund të sjellë gëzim të vërtetë në jetën tuaj. Ti mund të shkosh në një klub nate, apo pab dhe të shpenzosh mijëra lekë, por të garantoj se do të kalosh vetëm një kohë të mirë. Nëse je i pashpëtuar do të kalosh një kohë të mirë, sepse do të shikosh një shfaqje, pastaj do të delesh dhe do të hash si i babëzitur. Do të kalosh një kohë shumë të mirë atë natë, por në mëngjes nuk do të jetë më kështu. Do të ndihesh keq dhe nuk ke për ta marrë kurrë vesh se çfarë është gëzimi i vërtetë. Vetëm kur vjen tek Krishti, mund të provosh gëzimin e vërtetë.

“Për Judejtë ishte dritë, gëzim, gaz dhe lavdi.” [Est. 8:16].

Perëndia po të ofron dritën e Tij. Jezusi është drita e botës. Ai është shkëlqimi, gëzimi dhe nderi i botës. Ajo çfarë i jep dinjitet mëkatarëve është pranimi i Shpëtimtarit, që është Zoti i manifestuar në mish dhe që vdiq për ta. Kjo do t'i ngrejë mëkatarët nga balta dhe pislëku. Kjo do ta aftësojë një mëkatar të eci përmes kësaj bote me kokën e tij lart dhe me gëzim. Ne kemi nevojë për gëzim. A je i gëzuar sot, me një gëzim që vjen nga thellësia e zemrës tënde? Nëse nuk je i mbushur me gëzim, eja tek Krishti dhe Ai do të të japë dicka për të cilën mund të jesh i gëzuar.

“Në çdo krahinë dhe në çdo qytet, kudo që arrinte urdhri i mbretit dhe dekreti i tij, për Judejtë kishte gëzim dhe ngazëllim, bankete dhe ditë të lumtura. Dhe shumë nga pjestarët e popujve të vendit u bënë Judej, sepse tmerri i Judejve i kishte zënë.” [Est. 8:17].

Për shkak të tmerrit të judenjve shumë njerëz u bënë judenj. Kjo do të thotë se pranuan fenë e tyre. Kombi i Izraelit ishte një dëshmi e mirë për botën.

Këtu ka përfunduar studimi i kapitullit të 8-të dhe fillojmë studimin e kapitujve 9-të dhe 10-të.

Kapitujt 9 dhe 10

Tema: Krijimi i festës së Purimit

Dita e ekzekutimit të judenjve erdhi.

“Muajin e dymbëdhjetë, që është muaji i Adarit, ditën e trembëdhjetë të muajit, kur duhet të zbatoheshin urdhri dhe dekreti i mbretit, dita në të cilën armiqtë e Judejve shpresonin të sundonin mbi ta, situata u përmbys krejt dhe judenjtë sunduan mbi armiqtë e tyre. Judejtë u mblodhën në qytetet e tyre, në të gjitha krahinat e mbretit Asuero, për të shtrirë dorën kundër atyre që kërkonin t`u bënin keq; dhe askush nuk mundi t`u rezistonte atyre, sepse tmerri i Judejve i kishte zënë tërë popujt.” [Est. 9:1-2].

Judenjtë u përgatitën për sulmin. Dekreti i ri i mbretit i mbronte, kështu që bënë gjithcka gati për të mbrojtur veten. Është interesante të vësh re se Herodotusi, historian grek, rregjistron se Asuero u kthye në shtëpi pas disfatës së tij në fushatën greke rreth 480 vjet para Krishtit, dhe gruaja e tij Ametris, ishte një mbretëreshë e ftohtë dhe hakmarrëse. Kjo sigurisht që është Esteri. Edhe nga pamja e jashtme është mëse e kuptueshme që ajo dukej hakmarrëse dhe e ftohtë. Vec kësaj, ajo u dha fund veprimeve të këqija të Hamanit. Ajo ishte në

gjendje të shpëtonte popullin e saj nga armiqtë e tyre në atë kohë të vecantë.

Shumë njerëz mendojnë se ishte brutale dhe mizore, që një gjykatë të dënonte me burg disa nga pasuesit e Hitlerit, por ata ishin të parët që keqtrajtuuan hebrenjtë. Trajtimi i judenjve prej tyre në kampet e përqëndrimit ishte plotësisht cnjerëzor. Shumë njerëz që nuk dinin asgjë për njerëzit e Hitlerit mendonin që ata nuk duhet të trajtoheshin me një ashpërsi të tillë, por ata që e njihnin historinë nga brenda e dinin që ata morën drejtësinë.

“Tërë krerët e krahinave, satrapët, qeveritarët dhe ata që merreshin me punët e mbretit i përkrahën Judejtë, sepse tmerri i Mardokeut i kishte zënë.

Në fakt Mardokeu ishte i madh në pallatin e mbretit, dhe fama e tij përhapej në të gjitha krahinat, sepse ky njeri, Mardokeu, bëhej gjithnjë më i madh.” [Est. 9:3-4].

Mardokeu, njëri prej tyre, ndodhej në anë të mbretit. Hamani, që donte të shfaroste judenjtë, nuk ishte më. Froni që dikur i dënonte judenjtë, tani i mbronte.

Vetë froni i Zotit na mbron ne sot. Apostulli Pal thotë: *“Kush do t`i padisë të zgjedhurit e Perëndisë? Perëndia është ai që i shfajëson Kush është ai që do t`i dënojë? Krishti është ai që vdiq, po për më tepër ai u ringjall; ai është në të djathtë të Perëndisë dhe ai ndërmjetëson për ne.”* (Rom. 8:33-34). Vini re sesi shfajëson Ai: (1) Krishti vdiq; (2) Ai u ngrit sërish; (3) Ai është në të djathtë të Perëndisë dhe (4) Ai ndërmjetëson për ne. Këto janë arsyt përse askush nuk mund të dënojë një besimtar. Kjo është e mrekullueshme. Sot një Person është në lavdi. Ai e di saktësisht se si ndiheni. Në këtë pozitë Ai ndërmjetëson për ne. Gjërat kanë ndryshuar për ne mëkatarët. *“Duke pasur, pra, një kryepriest të madh që ka përshkuar qiejt, Jezusin, Birin e Perëndisë, le të mbajmë fort rrëfimin tonë të besimit. Sepse ne nuk kemi kryepriest që nuk mund t`i vijë keq për dobësitë tona, po një që u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar. Le t`i afrohemi, pra, me guxim fronit të hirit, që të marrim mëshirë e të gjejmë hir, për të pasur ndihmë në kohë nevojë.”* (Heb.4:14-16).

Unë kam një Shpëtimtar që përcmohet nga kjo botë. Një mal me blasfemi të pista thuhet për Të. Por, miq, Ai është Njeriu në

lavdi. Ai është Mbreti i mbretërve. Ai është Zoti i zotërve. Ai është zambaku i lëndinës. Ai është i Dashuri. Ai është komandanti i dhjetë mijë vetëve. Një ditë Ai do të vijë sërish. Ne duhet të praktikohemi të ulemi në gjunjë para Tij, duke e adhuruar dhe lavdëruar Atë. Kjo është shumë e rëndësishme. Cdo ditë që kalon, Ai duhet të bëhet më i ëmbël për ne. Në fakt është një këngë që quhet: “Më i ëmbël me kalimin e viteve.” Uroj që kjo të jetë e vërtetë për të gjithë ne. A gëzohesh më shumë si i krishterë sot se një vit më parë? Apo dhjetë vjet më parë? Unë falenderoj Zotin që jam një i krishterë më i lumtur sot sec isha dhjetë vite më parë.

Imagjinoni pak sikur disa izraelitë që jetonin në kohën e mbretëreshës Ester të thoshin: “Unë nuk e besoj se dekreti i ri ka ardhur nga mbreti. Nuk mendoj se mbreti është aq i mirë. Do ta mbroj veten në mënyrën më të mirë që mundem. Unë do të ndërtoj një fortesë dhe do të fshihem pas saj.” Miqtë e mi, për ata judenj që nuk e besuan dekretin e mbretit kishte vdekje. Vini re se judenjtë duhet të kishin besim në mesazhin e mbretit. Njëlloj si ata edhe ne duhet të kemi besim në mesazhin e Zotit, që është ungjilli. Ungjill do të thotë “lajm i mirë” Letra e parë e korintasve 15:3-4 na jep mesazhin e Zotit në një lëvozhgë arre: *“Sepse unë ju kam transmetuar para së gjithash ato që edhe unë vetë i kam marrë, se Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve se u varros dhe u ringjall të tretën ditë, sipas Shkrimeve.”* Perëndia nxorri një dekret për një botë të humbur. Burrat dhe gratë u shpëtuan me anë të besimit dhe jo me anë të veprave të ligjit. Gjoni 1:12 thotë për Zotin Jezus: *“por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij.”* E vërteta kryesore e mesazhit të Pjetrit ditën e Pentakostit ishte: nëpërmjet Krishtit vjen falja e mëkateve (shih Vep. 2).

Ungjilli i shpëton njerëzit sot. Ungjilli është ajo që ka bërë Jezusi për ne. Ai nuk është një kërkesë nga ana e Zotit për mua dhe ty që të bëjmë dicka. Përkundrazi, ungjilli është që Ai ka bërë për ne. Nëse nuk e vendosim besimin tonë tek Krishti, atëherë për ne nuk ka më shpresë. Ju ndoshta mund të hiqni dorë nga disa zakone të këqija, mund të braktisni të keqen, mund të shkoni në kishë, të pagëzoheni, të merrni darkën e Zotit dhe të jeni sërish copë-copë. E vetmja mënyrë për të pasur paqen e vërtetë është të dëgjosh Fjalën e Zotit dhe të besosh

mesazhin e Tij. Në momentin kur ju e besoni atë, atëherë do të vijë shpëtimi.

Judenjtë që nuk e besuan dekretin e mbretit nuk kishin shpresë. Por, ata që pranuan dekretin e ri të mbretit ishin të gëzuar dhe të lumtur. Pse? Besimi i tyre në dekretin e mbretit kishte sjellë clirim.

“Mardoheu i shkroi tërë këto gjëra dhe u dërgoi letra tërë Judejve që ishin në të gjitha krahinat e mbretit Asuero, afër dhe larg.” [Est. 9:20].

Shumë njerëz pyesin: “Kush e ka shkruar librin e Esterit?” besoj se ky pasazh na jep të paktën një sugjerim se Mardoheu ka qenë autori i saj.

“Prandaj ato ditë u quajtën Purim, nga fjala Pur. Në përshtatje, pra, me të gjitha ato që ishin shkruar në atë letër, me të gjitha ato që kishin parë lidhur me këtë dhe me ato që kishin ndodhur, Judejtë vendosën të zotoheshin pa iu shmangur për vete, për pasardhësit e tyre dhe për të gjithë ata që do të bashkoheshin me ta, të kremtonin çdo vit këto dy ditë sipas udhëzimeve të shkruara dhe kohës së caktuar.” [Est. 9:26-27].

Në kohën tonë, festa e Purimit përkujtohet nga judenjtë ortodoksë në sinagogat e tyre. Kjo është një festë gëzimi dhe mbyllet duke lexuar librin e Esterit. Ndërkohë që e lexojnë atë, ata pështyjnë për tokë, kur përmendet emri i Hamanit. E kuptoj që ata mund të përdorin një, ose dy shprehje: “Emri i tij u mbuloftë nga gjaku.” Ose “Qoftë mallkuar”. Ditën tjetër mblidhen bashkë për një shërbesë të gëzueshme, sepse festojnë faktin që Perëndia i cliroi sipas premtimit që i kishte bërë Abrahamit. Perëndia kishte thënë: “...Dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë...” (Zan. 12:3).

“Ato ditë duhet të kujtoheshin dhe të kremtoheshin brez pas brezi, në çdo familje, në çdo krahinë, në çdo qytet; në asnjë mënyrë Judejtë nuk duhet të hiqnin dorë nga

kremtimi i këtyre ditëve të Purimit, dhe kujtimi i tyre nuk duhet të zhdukej te pasardhësit e tyre.” [Est. 9:28].

Libri i Esterit mbyllet me një njoftim interesant në kapitullin e dhjetë:

“Mbreti Asuero i vuri një haraç vendit dhe ishujve të detit. Gjithë faktet e forcës dhe fuqisë së tij dhe përshkrimi i kujdesshëm i Mardokeut, i cili u ngrit nga mbreti, a nuk janë vallë të shkruara në librin e Kronikave të mbretërve të Medisë dhe të Persisë?

Judeu Mardoke vinte i dyti në fakt mbas mbretit Asuero, i madh midis Judejve dhe i dashur nga moria e vëllezërve të tij; ai kërkonte të mirën e popullit të tij dhe kishte fjalë paqeje për gjithë fisin e tij.” [Est. 10:1-3].

Unë dhe ti kemi një Shpëtimtar, që një ditë do të sjellë paqen e vërtetë për botën.

Interesant është fakti që judenjtë thanë tre lutje gjatë festës së Purimit. Në lutjen e parë ata falenderuan Jehovën, që u llogaritën të denjë. Në lutjen e dytë falenderuan Zotin për ruajtjen e stërgjyshërve të tyre. Në lutjen e tretë e falenderuan që kishin jetë për të shijuar edhe një festë tjetër.

Ne si të krishterë shohim në festën e Pashkës një kuptim shpirtëror – “... Krishti është pashka e sakrifikuar për ne.” (1 Kor. 5:7). Ai është shpëtimi i Zotit për ne. Në festën e Purimit shohim fuqinë e Zotit, kujdesin e Tij dhe sovranitetin e Tij. Autori i librit të Fjalëve të Urta thotë: “*Shorti hidhet që në barkun e nënës, por çdo veprim varet nga Zoti*” (Prov. 16:33). Ai do ta ruajë kombin e Tij, Izraelin. Ai do ta ruajë kishën e Tij. Ai do t’i ruajë individët që janë të Tijët. Ai është në gjendje të shpëtojë të gjithë ata që vijnë tek Zoti përmes Tij.

Është një komentari i trishtueshëm për brezin e sotëm që shumica e të krishterëve njohin vetëm shumë pak nga kujdesi i Zotit. Ata nuk mësojnë të ecin në miqësi të ngushtë me Zotin dhe t’i binden Fjalës së Zotit.

“Ai di, do dhe kujdeset,
Asgjë nuk mund ta zbehë këtë të vërtetë:
Ai u jep më të mirën atyre

Që ia lënë zgjedhjen Atij.”

Miqtë e mi, Ai dëshiron të drejtojë me anë të syve të Tij. Ne duhet t’i afrohemi Atij më shumë sot. Shumica e besimtarëve njohin vetëm pak nga kujdesi i Zotit.

Sa të krishterë sot ecin sipas vullnetit të tyre! Gjërat shkojnë për mrekulli. Dielli shkëlqen në qiell dhe gurët janë larguar nga rruga e tyre. Ata mendojnë se mund të bëjnë gjithcka vetë, kështu që nuk shikojnë tek Zoti. Por, një ditë era fillon të fryjë fortë, dallgët fillojnë të përplasen, rruga duket e errët dhe krejt papritur ata i thërrasin Atij: “Zot, më shpëto. Jam duke vdekur! Më trego rrugën!” Nëse e kalojnë atë krizë thonë: “Zoti më drejtoi.” Miqtë e mi, Ai të drejtojë vetëm me anë të kujdesit të Tij. Ti ishte jashtë vullnetit të Zotit.

Sot thuhet shumë gjëra në lidhje me përkushtimin e jetës dhe të zemrës. Unë lodhem duke dëgjuar: “Ejani dhe përkushtojani jetën tuaj Zotit.” Miqtë e mi, nuk ju kërkoj ta bëni këtë. Ju mund të uleni në gjunjë tani, t’ia dedikoni jetën tuaj Zotit dhe nesër të jeni plotësisht jashtë vullnetit të Tij. Perëndia dëshiron t’ju drejtojë sot. Ai dëshiron t’ju drejtojë drejtpërdrejtë. Nuk ka rëndësi se kush je, apo se ku po shkon, Ai do të sundojë mbi ty. Ti mund të jesh një Hitler, një Stalin, ose edhe një Jud Iskariot. Perëndia sundonte mbi Judën dhe sundon edhe mbi ju. Ju mund ta njihni gëzimin dhe harenë e ardhjes tek Ai, jo vetëm me anë të një veprimi, por moment pas momenti, ditë pas dite duke kërkuar vullnetin e Zotit për jetën tuaj. Ju mund të filloni që sot të ecni në vullnetin e Zotit. Oh sa gëzim që është të ecësh në vullnetin e Zotit.

Gjithsesi, nëse dilni nga vullneti direkt i Zotit, ju nuk do të jeni jashtë kujdesit të Tij. Perëndia qëndron në hije, duke mos i hequr sytë nga të Tijët.